

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "ORION" shpk**

Nr. 34, datë 20. 07. 2022

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT TË
SHOQËRISË TREGTARE “ORION” shpk”**

Sot, në datën 20.07.2022, në orën 10:00 AM, në selinë e shoqërisë “ORION” shpk u mbledh Asambleja e zakonshme e Shoqërisë me pjesëmarrjen e zotëruesve të 100% të kuotave.

Në mbledhje janë prezent personalisht Ortakët e Shoqërise (në vijim “ortakët”), përkatësisht:

- zoti Ardian Nelo, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepuar dhe me pjesët e zotëruara 75 %.

- zoti Niazi Nelo, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepuar dhe me pjesët e zotëruara 25 %.

Asambleja ka për rend dite:

1. Fillimin e procedurave për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “ORION” shpk.
2. Caktimin e Ekspertit Vlerësues të Pasurive të Paluajtshme dhe të Audituesit Ligjor.
3. Të ndryshme.

Në përfundim të mbledhjes, mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ortakët së bashku në cilësinë e Asamblesë së Ortakëve:

DUKE QËNË SE:

- “ORION” shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shqiptare, themeluar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 12.05.1998, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me Numër Unik Identifikimi të Subjektit NUIS J81715002Q;

- Shoqëria me aktivitetin e saj ka investuar dhe aktualisht është në një fazë intensive investimi për zgjerimin e kapaciteteve dhe zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe po zgjeron planin e investimeve të saj;

- Të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhjeje dhe vendimmarrjeje të rregullt janë përmbushur në përputhje me Statutin e Shoqërise dhe Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.



VENDOSËN:

1. Të miratojnë fillimin e procedurës për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “ORION” shpk.
2. Të caktojnë ekspertët e vlerësimit të pasurive të paluajtshme zotin Ilirjan Proko dhe zonjën Sonila Pashaj për të vlerësuar pronën në pronësi të ortakut Ardian Nelo, e cila do të kalojë si kontribut në natyrë për rritjen e kapitalit të shoqërisë “ORION” shpk dhe shoqërinë audituese “I.L.D-99 Audit” shpk për të hartuar raportin përkatës të rritjes së kapitalit.
3. Raportet e vlerësimit të pronës të paluajtshme të sipërcituar dhe të auditimit ligjor të paraqiten me shkrim në selinë e “ORION” shpk menjëherë pas hartimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë “ORION” shpk

Ardian Nelo

Niazi Nelo



**VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "ORION" shpk**

Nr. 35, datë 02.08.2022

“PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË TREGTARE “ORION” shpk”

Sot, në datën 02.08.2022, në orën 10:00 AM, në selinë e shoqërisë “ORION” shpk u mbledh Asambleja e zakonshme e Shoqërisë me pjesëmarrjen e zotëruesve të 100% të kuotave.

Në mbledhje janë prezent personalisht Ortakët e Shoqërise (në vijim “ortakët”), përkatësisht:

- zoti Ardian Nelo, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepuar dhe me pjesët e zotëruara 75 %.

- zoti Niazi Nelo, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepuar dhe me pjesët e zotëruara 25 %.

Asambleja ka për rend dite:

1. Miratimin e Raportit të Vlerësuesit të Pasurive të Paluajtshme për vlerën e pronës që do të perfshihet në kapital, si dhe Raportin e rritjes së kapitalit të Audituesit Ligjor “I.L.D-99 Audit” shpk;
2. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë “ORION” shpk;
3. Të ndryshme.

Në përfundim të mbledhjes, mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë-tregtare”, i ndryshuar, Ortakët së bashku në cilesinë e Asamblesë së Ortakëve:

DUKE QËNË SE :

- “ORION” shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shqiptare, themeluar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 12.05.1998, regjistruar në Qendren Kombetare të Regjistrimit (QKR), me Numer Unik Identifikimi të Subjektit NUIS J81715002Q;

- Shoqëria “ORION” shpk me vendimin e mëparshëm të saj nr. 6, datë 20.07.2022 ka vendosur fillimin e procedurës së zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

- Ekspertët vlerësues të pasurive të paluajtshme zoti Ilirjan Proko dhe zonja Sonila Pashaj ka paraqitur Raportin e Vlerësimit të pasurisë të paluajtshme me shkrim dhe shoqëria “ILD-99 Audit” shpk ka paraqitur me shkrim Raportin përkatës, si dhe të dy ortakët e shoqërisë janë njohur me përmbajtjen e tyre;

- Të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhjeje dhe vendimmarrje të rregullt janë përmbushur në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.



VENDOSËN:

1. Miratimin e raportit të Vlerësuesit të Pasurive të Paluajtshme për vlerën e pronës që do të perfshihet në kapital si edhe vlerën e pronës në shumën 2 640 000 (dy milion e gjashtëqind e dyzet mijë) euro ose 308 880 000 (treqind e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) leke, me kursin 1euro = 117 leke.

Miratimin e Raportit të rritjes së kapitalit hartuar nga Audituesi Ligjor “I.L.D-99 Audit” shpk.

2. Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “ORION” shpk me anë të kontributit në natyrë të ortakut Ardian Nelo me pasurinë e paluajtshme prej 22 000 m², tokë kullotë, të ndodhur Zonën Kadastrale 1739, Gjilek, Himarë, sipas vërtetimit të ASHK-së nr. 331, datë 30.04.2021, e cila do të kalojë nga pronësia personale e ortakut Ardian Nelo në kapitalin e shoqërisë “ORION” shpk, në shumën e vlerësuar nga ekspekti i licensuar prej 2 640 000 (dy milion e gjashtëqind e dyzet mijë) euro ose 308 880 000 (treqind e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) leke, me kursin 1euro = 117 leke.

Në këtë mënyrë kapitali i shoqërisë “ORION” shpk nga 39,000,000 lekë shtohet edhe me 308, 880,000 lekë dhe bëhet 347, 880, 000 lekë.

Zotërimi i kuotave të shoqërisë “ORION” shpk pas rritjes së kapitalit është si vijon:


Ortaku	Nr. kuotave	Vlera në lekë	Në përqindje mbi kapitalin e shoqërisë
Ardian Nelo	1	338,130,000	97.2%
Niazi Nelo	1	9,750,000	2.8%

3. Ngarkohet zonja Medea Nasho të bëjë depozitimin e këtyre vendimeve, respektivisht të datës 20 korrik 2022 dhe 2 gusht 2022, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “ORION” shpk në QKB.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë “ORION” shpk

Ardian Nelo



Niazi Nelo

